Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-4168
Datë 16.11.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Kolegjit UBT në Prishtinë, për periudhën 1 vjeçare, prej 31. 10. 2016 deri 31. 10. 2017 për kurse për:

   1.1. Gjuhë Angleze.

   Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

   Kushtet:

   - Të sigurojë dëshmi të politikës mbi zhvillimin profesional të shkathtësive të mësimdhënies i cili mbështetet në udhërrëfyesin e AKK-së si dhe të sistemeve efektive për implementimin e kësaj politike.
   - Të përpilojë praktikat e vlerësimit të testit përfundimtar me gojë ashtu që vlerësimi të jetë më objektiv dhe i mbështetur në përshkrimet e KPERGJ-së
   - Të përgatisë një plan fillestar financiar për vitin akademik 2016/2017
   - Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të secilit anëtar të stafit të QPGjA-së.
   - Stafi mësimdhënës duhet të plotësojë standardet sa i përket nivelit të kualifikimit.
   - Nxënësve dhe stafit në të gjitha qendrat duhet t'u bëhet e ditur procedura mbi evakuimin në raste emergjente.

   (Afati kohor: 01. 02. 2017).

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 31.10.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Kolegji UBT në Prishtinë; dhe
- AKK.

Nën- kryetari i KD së AKK
Anton Gojani